



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2020:906862

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05844255

**C.nr.40/21**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a (KEK) me seli në Prishtinë, Sheshi “Nëna Terezë” nr.36, të cilën e përfaqëson Fahri Fazliu me autorizim në shkresat e lëndës, kundër të paditurit H. L. nga fshati B./Malishevë, të cilin me autorizim e përfaqëson Daut Krasniqi avokat në Mlaishevë, lidhur me borxhin për shpenzimin e energjisë elektrike në shumën prej 2,829.47 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të datës 18.06.2024 të mbajtur në prezencë të autorizuarit të paditëses dhe të autorizuarit të paditurit, me datë 21.06.2024 mori dhe përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. ANULOHET aktvendimi** i Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë mbi lejimin e ekzekutimit E.nr.453/13 i datës 05.04.2013 lidhur me propozimin për ekzekutim në shumën prej 3,144,31 euro
- II. APROVOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a (KEK) me seli në Prishtinë, për borxh lidhur me energjinë elektrike të shpenzuar nga i padituri, ashtu që **DETYROHET** i padituri H. L. nga fshati B./Malishevë, që t’ia paguaj paditëses shumën prej **310.61 € (treqind e dhjetë euro e gjashtëdhjetë e një cent)**, dhe atë në emër të borxhit për shpenzimin e energjisë elektrike nga data 01/01/2012 e deri me datën 02.04.2013 (deri në datën e parashtrimit të padisë), me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga data e precizimit/specifikimit të padisë 21.05.2024.
- III. REFUZOHET si e pabazuar** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses mbi shumën e aprovuar sikurse në pikën -II- të dispozitivit të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar, ose refuzohet shuma prej 2,518.86 € (dymijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë euro e tetëdhjetë e gjashtë cent) në emër të borxhit për shpenzimin e energjisë elektrike deri me datën 31.12.2011, **si e parashkruar**.
- IV.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

## A r s y e t i m

Paditësja/kreditorja Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a (KEK) me seli në Prishtinë me datën 02.04.2013 në këtë gjykatë ka parashtruar propozim për ekzekutim kundër të paditurit/debitorit H. L. nga fshati B., lidhur me borxhin fillimisht në shumën prej 3,144.31 euro.

Gjykata përmes aktvendimit E.nr. .nr.453/13 të datës 05.04.2013 ka lejuar ekzekutimin, ndërsa debitori, tani i padituri në afatin ligjor ka parashtruar kundërshtim me të cilin e ka kundërshtuar ekzekutimin e lejuar të kësaj gjykate, kështu që gjykata pas parashtrimit të kundërshtimit, propozimin për ekzekutim e ka konsideruar padi, bazuar në dispozitat e LPP-së.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, kjo gjykatë ka vendosur me Aktgjykim C.nr.306/2013 të datës 07.11.2017, me të cilin e ka anuluar aktvendimin e kësaj gjykate E.nr.453/13 të datës 05.04.2013, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe e ka detyruar të paditurin që në emër të borxhit për shpenzimin e energjisë elektrike, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 3,144.31 euro.

Gjykata e shkallës së dytë me Aktvendimin A.C.nr.249/2018 të datës 28.01.2021 e ka prishur aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën e ka kthyer në procedim të serishëm (lëndë e cila ka marrë numër të ri C.nr.40/21), ndërsa gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas rekomandimeve të gjykatës së shkallës së dytë ka mbajtur seancë, në të cilën kanë prezantuar palët ndërgjyqëse.

Në seancën përgatitore dhe gjatë shqyrtimit kryesor, të mbajtur me datë 21.05.2024 dhe 18.06.2024, i autorizuari i paditëses ka deklaruar se mbesin pranë padisë dhe kërkesëpadisë, por tani duke e precizuar/specifikuar borxhin që ka qenë në shumën prej 3,144.31 euro, ashtu që meqë i padituri e ka paguar një pjesë të borxhit, atëherë tani e ka specifikuar shumën e përgjithshme të borxhit, dhe tani ky borxh në total ka deklaruar se është 2,829.47 euro, dhe ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar me kamatë ligjore.

E ka kundërshtuar propozimin sa i përket parashkrimit në të cilin është thirrur i padituri, duke thënë se nuk kemi të bëjmë me parashkrim sepse i njëjti ka bërë pagesa herë pas here dhe e dihet që parashkrimi ndërpritet me bërjen e pagesave dhe nga transaksioni i konsumatorit shihet qartë se pala ka bërë pagesa 100, 30, 50 euro e tutje.

Në seancat e mëhershme i ka kërkuar shpenzimet e procedurës por pa i specifikuar ato, si dhe shpenzimet e taksës gjyqësore.

I autorizuari i paditëses, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi si në deklaratimet e cekura gjatë seancave të mbajtura duke konsideruar se bazuar në shkresat e lëndës, është vërtetuar baza e kërkesëpadisë, andaj i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të njëjtën ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Në anën tjetër, i autorizuari i të paditurit av. Daut Krasniqi në seancat e mbajtura me datë 21.05.2024 dhe 18.06.2024 e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paraqitur nga paditësja, për arsye se nuk është e bazuar në rrethana faktike e provave as në dispozita ligjore të procedurës kontestimore. Ka shtuar se kërkesëpadia nuk është e qartë dhe është kontradiktore me vetveten, dhe në këtë lëndë është sjell edhe një aktgjykim i Gjykatës Themelore Gjakovë dega në Malishevë C.nr. 306/2013 i dt. 07.11.2017 të cilin pas paraqitjes së ankesës nga i padituri, Gjykata e Apelit e ka prishur aktgjykimin për arsye se ka pasur të meta të shumta dhe i ka dhënë rekomandime se si duhet të veprohet. Me aktvendimin e gjykatës së apelit AC.nr.249/2018, në arsyetim thuhet se është anuluar aktvendimi mbi lejimin e ekzekutimin E.nr. 453/13 i dt. 05.04.2013 të cilin e ka anuluar dega e gjykatës në Malishevë, që realisht nuk ka pasur të drejt për arsye se ajo është procedurë ekzekutive përmbarimore pra këtë çështje duhet ta sqaroj paditësi. Edhe borxhi kinse ekziston sipas paditëses nuk është i definuar saktë por në mënyrë paushalle sipas vlerësimit personal të zyrtarëve të KEK-ut ku thuhet se i padituri nuk ka paguar mjaftueshëm energjinë elektrike, pastaj janë paraqitur shuma enorme që nuk përputhen me fazat e mëhershme që i ka paguar i padituri nga 20 euro në muaj, por këto shuma paushallë janë nga 100 euro në muaj.

Ka konsideruar se edhe bazuar në dispozita ligjore, kjo kërkesëpadi e KEK-ut është e parashkruar për arsye se me nenin 360 të LMD-së, për afatin e parashkrimit thuhet se kërkesat për furnizim me energjinë elektrike, energji termike, të gazit, të ujit, dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe në mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse këto shërbime janë bërë për nevoja shtëpiake, parashkruhen pas një viti, që do të thotë se edhe tani që është paraqitur padia kanë kaluar qe 11 vite, kështu që bazuar në këto të dhëna konsiderojmë se padia e paditësit nuk i plotëson kriteret e Ligjit të procedurës kontestimore dhe si e tillë duhet të refuzohet.

I padituri H. L. ka deklaruar se mbështetë deklaratën e të autorizuarit të tij duke shtuar se nuk mund ta përballon borxhin e deklaruar nga KEK-u, për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, dhe përveç kësaj bashkëshorten thotë se e ka pasur të sëmurë 6 vite me kancer si dhe vetë ka probleme shëndetësore.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklarimeve të mëparshme dhe provave të sjella, duke konsideruar se provë kryesore është aktvendimi i gjykatës së apelit në Prishtinë AC.nr.249/2018 e cila e ka anuluar aktgjykimin e mëparshëm dhe aktvendimet që janë sjellë më herët, me rekomandimin kryesor se kërkesëpadia nuk është e precizuar saktë dhe ka shuma paushalle që nuk mund të ekzaminohen dhe bazuar në këto prova dhe fakte, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar.

I ka kërkuar shpenzimet procedurale, tani për 3 seanca të mbajtura nga 135.00 euro gjithsejtë 405.00 euro dhe shpenzimet e mëparshme që janë bërë sipas aktgjykimeve dhe aktvendimeve.

Në seancën e datës 21.05.2024, meqë palët nuk kanë pasur ndonjë propozim, atëherë duke u mbështetur në nenin 356 të LPK-së, lidhur me nenin 21 të ligjit nr.04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjykata sipas detyrës zyrtare e ka caktuar marrjen e provës me ekspertizë nga lëmia/fusha e Energjetikes për

ta saktësuar vlerën e dëmit, i cili ekspert është dashur të caktohet me aktvendim të veçantë pas deponimit të mjeteve nga pala paditëse në një afat prej 7 ditësh, mirëpo edhe përkundër kalimit të këtij afati, pala paditëse nuk ka deponuar shumën për ekspertizë, andaj është konsideruar se pala paditëse ka hequr dorë nga nxjerrja e kësaj prove.

Administrimi i provave dhe vlerësimi i tyre:

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor publik, ka administruar këto prova: është bërë shikimi i transaksionit të konsumatorit të i datës 26.03.2013 me numër ..., shikimi i transaksionit të konsumatorit i datës 14.02.2016 ku shuma totale e borxhit sipas faturës të datës 20.03.2013 ka qenë 3,144.31 euro dhe është bërë shikimi i transaksionit të konsumatorit i datës 20.05.2024 nr.DGJ-... ku shuma e borxhit sipas këtij transaksioni është 2,829.47 euro.

Gjykata pas vlerësimit të thënieve të palës ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar dhe si e tillë edhe u aprovua,

Nga shikimi i transaksionit të konsumatorit të i datës 26.03.2013 me numër ..., është vërtetuar se konsumatori (i padituri) H. L. prej kohës së pacaktuar e deri me datën 26.03.2013, për energjinë e shpenzuar i ka borxh paditëses (KEK) shumën e përgjithshme prej 3,144.31 euro.

Nga shikimi i transaksionit të konsumatorit DGJ-... i datës 14.02.2016, është vërtetuar se i padituri prej datës 27.09.2009 e deri me datën 20.03.2013, për energjinë elektrike të shpenzuar në bazë të faturave mujore, i ka borxh paditëses KEK, shumën e përgjithshme prej 3,144.31 euro.

Ndërsa nga transaksioni i fundit i konsumatorit DG-... i datës 20.05.2024, vërtetohet se shuma e përgjithshme e borxhit të konsumatorit/të paditurit, për energjinë elektrike të shpenzuar në bazë të faturave mujore, është në shumën e përgjithshme prej 2,829.47 euro.

Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e të paditurit lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, dhe pas analizimit të këtyre pretendimeve në raport me provat të cilat ndodhën në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të një pjese të kërkesës së paditësit, më saktësisht është parashkruar borxhi deri me datën 31.12.2011.

Kjo për faktin se me dispozitën e nenit 360 paragrafi 1, pika 1.1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077), përcaktohet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: Kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: *“Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*.

Kurse me nenin 368 paragraf 1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077) përcaktohet se: *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”*, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: *“Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthorë, sikurse janë pagesa e kështit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*. Po ashtu edhe me nenin 369 të LMD-së, të këtij ligji përcaktohet se: *“Parashkrimi ndërprehet me*

*paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”.*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave shihet se, kërkesat për furnizim me energji elektrike parashkruhen brenda afatit prej një viti, ndërsa afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilin kërkesa arrin për pagesë. Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e të paditurit lidhur me afatet e parashkrimit dhe ka ardhur në përfundim, se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrim të pjesshëm të kërkesës së paditësit në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 pika 1.1 lidhur me par. 2 të LMD-së.

Paditësi ka kërkuar kthimin e borxhit lidhur me faturat për periudhën nga koha e pacaktuar e deri me datë 20.03.2013. Bazuar në këtë, rezulton se borxhi i të paditurit është parashkruar deri me datë 31.12.2011, ngase nga dita kur janë bërë të arritshme kërkesat periodike për këtë periudhë, e deri në ditën kur është paraqitur propozimi/padia me datë 02.04.2013, kanë kaluar më shumë se një vit, andaj gjykata konstaton se në rastin konkret lidhur me periudhën kohore të cekur si më lartë (deri me datë 31.12.2011) kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, kjo për faktin se ka kaluar koha e paraparë me ligj brenda të cilit paditësi mund të kërkojë borxhin karshi të paditurit.

Andaj, për këtë pjesë të borxhit të akumuluar para datës 31.12.2011 pasi që kemi të bëjmë me shërbimet e për furnizim me energji elektrike, të cilat kërkesa hyjnë në kategorinë e kërkesave një vjeçare, gjykata vlerëson se ka kaluar afati i paraparë me dispozitën e lartcekur-afati i parashkrimit, pas kalimit të të cilit afat, kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore, andaj edhe vendosi si në pikën -III- të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Lidhur me aprovimin pjesërisht si të bazuar si në dispozitivin -II- të këtij aktgjykimi, për shumën e borxhit prej 310.61 euro, gjykata është bazuar në faturat e energjisë-Transaksionin e konsumatorit DGJ-..., ku bazuar në këtë, vërehet qartë se i padituri ka bërë pagesa të energjisë elektrike, ndërsa në precizim gjatë seancës, i autorizuari i paditësit e ka specifikuar borxhin duke shtuar se i padituri i ka borxh paditëses shumën totale prej 2,829.47 euro, e kur kësaj ia zbresim shumën e parashkruar para datës 31.12.2011, pra shumën prej 2,518.86 euro, atëherë del se borxhi total i të paditurit është 310.61 euro (shuma e kërkuar 2,829.47 euro – shumën e parashkruar 2,518.86 euro = 310.61 euro). Pra, do të thotë se pjesa tjetër e borxhit (2,518.86 euro) është akumuluar ose grumbulluar më herët, pra para datës 31.12.2011 dhe e njëjta është parashkruar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se i padituri e ka pranuar borxhin duke bërë pagesa të kohëpaskohshme dhe rrjedhimisht është ndërprerë afati i parashkrimit, ngase sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev.nr.148/2012 i datës 09.09.2013 parashihet se pagesat eventuale që janë bërë për një periudhë nga debitori në formë të ndonjë pagese nuk shkaktojnë ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, nëse ato nuk i referohen ndonjë pagese të ndonjë fature fikse për muajin gjegjës, përveç nëse mes palëve ka marrëveshje për riprogramim të borxhit apo ka specifikime të kërkesës për të cilën bëhet pagesa, e që në rastin konkret nuk ekzistojnë.

Në këtë kuptim, referuar situatës konkrete në këtë çështje kontestimore, gjykata vlerëson se, tek detyrimet e të paditurit ndaj paditësit, në rast se i padituri kryen pagesa dhe në pagesë e thekson saktë numrin e faturës të cilën e ka paguar, atëherë parashkrimi ndërpritet vetëm për atë faturë për të cilën është kryer pagesa, ndërsa në rastet kur kryhen pagesa, por pa e përcaktuar decidivisht numrin e faturës e cila paguhet, atëherë shuma e paguar e borxhit llogaritet si përmbushje e detyrimit më të vjetër të arritur për pagesë, dhe një pagesë e tillë nuk ka për konsekuencë edhe ndërprerjen e parashkrimit për të gjitha faturat, për shkak se siç u tha më lartë, kërkesat periodike janë kërkesa të veçanta nga njëra tjetra.

Për më tepër siç u cek edhe më lart, sipas interpretimeve dhe konstatimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në një rast tjetër gjyqësor, me rastin e sqarimit të çështjes së ndërprerjes së parashkrimit me pagimin e borxhit, e njëjta gjykatë sqaron dhe konstaton se edhe pagesat e bëra kohë pas kohe lidhur me borxhin periodik, nuk e bën ndërprerjen e afatit të parashkrimit, ngase në rastin konkret borxhi për shpenzimet e energjisë elektrike është borxh periodik i cili arrin pas përfundimit të çdo muaji dhe afati i paraparë në nenin 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së, për parashkrim rrjedh për secilin muaj nga momenti i përfundimit të atij muaji, që do të thotë parashkrimi tek borxhi periodik që ka të bëjë me shpenzimin e energjisë elektrike, llogaritet në secilin muaj në mënyrë të veçantë.

Andaj, Gjykata vlerëson se me pagesat e kohëpaskohshme të cilat i ka bërë i padituri, assesi nuk e ka pohuar detyrimin ndaj paditësit, detyrimi në fjalë quhet i pohuar, kur palët dakordohen për riprogramim të borxhit duke përcaktuar afatet brenda të cilave i padituri do të detyrohej ta përmbushte detyrimin e tij ndaj paditësit në këste të arritura sipas marrëveshjes. Faturat mujore të pranuar nga debitori nuk e kanë karakterin e kështit mujor, pasi termi kësht apo shumë periodike (zakonisht mujore), iu referohet kontratave kur ndërgjyqësit janë pajtuar paraprakisht për shumat fikse të përmbushjes së detyrimit, mos përmbushja e të cilave apo përmbushja eventuale do të pas sillte ndërprerjen e rrjedhjes së parashkrimit.

Gjykata, me rastin e vendosjes ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e precizimit të padisë (21.05.2024).

Vendimi që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, është marrë në bazë të dispozitave ligjore të nenit 449 par.1 i cili para sheh se: “*Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor*” lidhur me nenin 463 par.1 i cili parasheh se: “*Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën* ” dhe “*Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës*”, e lidhur me nenin 452 par.2 i cili parasheh se: “*Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve*”, andaj, duke mare

parasysh suksesin e palëve ndërgjyqëse në këtë procedurë, atëherë gjykata ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale, duke konsideruar se nuk do të ishte e drejtë ngarkimi i palës tjetër me shpenzimet e procedurës.

Duke u bazuar nga të gjitha këto që u thanë më lart dhe në kuptim të nenit 142 dhe 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.40/21, datë 21.06.2024**

**Gj y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.